



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada – Government

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva i Ruralnog Razvoja - Ministry of Agriculture,
Forestry and Rural Development

ZYRA PËR KOMUNIKIM ME PUBLIKUN/KANCELARIJA ZA JAVNO
KOMUNICIRANJE/OFFICE OF PUBLIC COMMUNICATION

SHPALLJE PUBLIKE

Për mbështetje financiare për organizatat dhe shoqatat e prodhuesve dhe përpunuesve të produkteve bujqësore dhe agro-ushqimore

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural do të mbështesë Organizatat dhe Shoqatat e Prodhuesve, Përpunuesve të Produkteve Bujqësore dhe Agro-ushqimore vendore, vetëm në një projekt brenda vitit kalendarik, sipas Udhëzimit Administrativ për Caktimin e Kriteve Mbështetëse për Organizatat dhe Shoqatat e Prodhuesve dhe Përpunuesve të Produkteve Bujqësore dhe Agro-ushqimore .

Aplikuesit mund të aplikojnë për realizimin e aktiviteteve në bujqësi dhe zhvillim rural, si:

- Trajnime;
- Këshilla;
- Kampanje informative, tryeza, seminare, punëtori;
- Promovime, ekspozita, panaire;
- Aktivitete të karakterit garues;
- Ditë fushore.

Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim:

- Aplikacioni i plotësuar; (*mund ta shkarkoni ne uebfaqen e ministrisë apo mund ta merrni fizikisht në zyrën përkatëse të aplikimit*)
- Kopja e letërnjoftimit të Republikës së Kosovës;
- Konfirmimi nga banka për xhirollogarinë bankare të aplikuesit;
- Projekt propozimin/planin e biznesit;
- Certifikata e regjistrimit të OJQ-së;
- Certifikata e regjistrimit të biznesit për personat juridik;
- Certifikatën e TVSH-së;
- Certifikata e Numrit Fiskal, dhe
- CV të eksperteve.

Periudha e aplikimit:

Aplikimi zgjatë **22 ditë** kalendarike dhe fillon prej datës **20 Mars 2015 deri më 10 Prill 2015**.

Mënyra e aplikimit:

- Të gjithë aplikuesit fillimisht gjatë aplikimit janë të obliguar të plotësojnë formularin për aplikim, i cili është parakusht për përfitim të mbështetjes.
- Gjatë procedurës së shqyrtimit të dokumentacionit dhe kontrollit, në rast të gjetjes së shkeljeve do të zbatohen masat ndëshkimore, duke u sanksionuar sipas nenit 38 Ligjit nr. 03/L-098 për Bujqësi dhe Zhvillim Rural (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.56/27.07.2009) dhe nenit 38 A Ligji Nr.04/L-090 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.03/L-098 për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.26/16 Tetor 2012).

Vendi i dorëzimit:

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural - Sheshi."Nëna Terezë", Zyra Nr.: 242 (Arkiva)

Vërejtje:

- Dokumentacioni për aplikim duhet të dorëzohet i kompletuar dhe në dy (2) kopje, brenda periudhës kohore të aplikimit.
- Dokumentacioni i dorëzuar pas përfundimit të afatit të publikuar, nuk do të pranohet për shqyrtim.